



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2024:334053

Datë: 28.01.2025

Numri i dokumentit: 06765795

**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL**, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në lëndën penale kundër të pandehurit J.M. me numër të letërnjoftimit ... për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 par 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.1412/2024, të datës 22.11.2024, si dhe bazuar në nenin 15 paragraf 1 të Ligjit nr.06/L-009 për Ndërmjetësim më datë 29.01.2025 mori këtë:

#### AKTVENDIM

- APROVOHET marrëveshja e arritur në procedurë të ndërmjetësimit** në lëndën **P.nr.357/2024** dhe me numër të marrëveshjes **ND:22/2025**, e arritur me datën 29.01.2025 e pranuar nga gjyqtari me datë 29.01.2025, për të pandehurin e cekur si në pjesën hyrëse të këtij aktvendimi.
- Marrëveshja e arritur në ndërmjetësim, e fiton fuqinë e vendimit të formës së prerë dhe dokumentit përmbarues sipas dispozitave ligjore në fuqi përfshirë këtu edhe dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarimore.
- Vendimi iu dorëzohet palëve dhe kundër të njëjtit, sikurse dhe kundër marrëveshjes së arritur, palët nuk kanë të drejtë ankese.
- Prishjen apo anulimin e marrëveshjes së arritur në ndërmjetësim, palët kanë të drejtë ta kërkojnë vetëm me padi të veçantë gjyqësore.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI –  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2024:334053, 29.01.2025

**Gjyqtari  
Agron Maxhuni**

